



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E PEJËS
OPŠTINA PEĆ
MUNICIPALITY OF PEJA

Në mbështetje të nenit 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/ 03 Prill 2019, neneve 8.9 dhe 10 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënjës në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës e datës 10 gusht 2020, Vendimit mbi miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës Nr. 400/01-8274, dt.26. Shkurt 2026, Vendimit paraparak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës Nr-463/01/40972, dt.29. Qershor 2026, dhe Vendimit për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës Nr.016/01-40984, të datës 29 Qershor 2026, Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës së Pejës, shpallë:

NJOFTIM PËR PJESËMARRJE NË ANKAND PUBLIK

I. Komuna e Pejës në pajtim me Vendimin e Kuvendit Komunal Nr-463/01/40972 dt.29 Qershor 2026, Vendimit për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës Nr.016/01-40984 të datës 29 Qershor 2026 jep në shfrytëzim afatshkurtër për 5 (pesë) vite, dy (2) sportelet në objektin Qendror të Administratës së Komunës së Pejës si në vijim

N r.	Pronar	Parcela Kadastrale	Adresa	Sipërfaqe -m2	Destinimi
1.	Komuna e Pejës	2 (dy) Sportelet në objektin e Administratës Qëndrore të Komunës së Pejës	Rr. "Hasan Prishtina" Objekti Qendror i Administratës së Komunës së Pejës	1.Objekti nr 1. 5.55m ² II.Objekti nr 2. 5.55m ²	Ushtrimi i aktiviteteve shërbyese financiare/pagesave

Sportelet e lartëcekura ipen në shfrytëzim afatshkurtër me qëllim të ushtrimit të aktiviteteve shërbyese financiare/ pagesave për të realizuar Interesin Publik, përkatësisht të hyrave vetanake dhe rritje e vlerës së pronës publike komunale.

Ky destinim përbën kushtin kryesor, të detyrueshëm dhe të pa negocueshëm për pjesëmarrje në ankand publik

-Çmimi fillestar i qirasë për një muaj është **200 € (Dyqind euro)** për një sportel.

Njoftohen personat fizik dhe personat juridik të cilët dëshirojnë të konkurojnë në ofertat e tyre për marrjen në shfrytëzim të sporteleve të lartëcekura, se hapja e ankandit publik dhe vlerësimi i ofertave do të mbahet në Sallën e Kuvendit Komunal me datë **14.09.2026** duke filluar nga ora **14:30**.

Pagesa e çmimit nga ofertuesi fitues në ankand do të bëhet në pajtim me Kontratën për dhënien në shfrytëzim për periudhën 5 vjeçare të sporteleve në 2 këste të barabarta me obligim të pagesës në momentin e nënshkrimit të kontratës për periudhë 1 vjeçare (kësti i parë).

Sportelet do të ipen në shfrytëzim në gjendjen ashtu siç janë në ditën e shpalljes së këtij ankandi, kështu që pas lidhjes së kontratës, kërkesat për riparim të sporteleve nuk do jenë obligim dhe nuk do të miratohen nga Komuna për zbritjen e çmimit të kontraktuar.

Aplikuesit mund të konkurojnë për marrjen në shfrytëzim të sporteleve të cekura sipas parimit një ofertë për sportel

Pjesëmarrësve në ankand u garantohet e drejta që të:

- 1.Të informohen me procedurat e ankandit publik;
- 2.Të shohin pronën që jepet në shfrytëzim;
- 3.Të kenë qasje në dokumentacionet e pronës;
- 4.Të tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre ditë para mbajtjes së ankandit publik.

Konkurimi për pjesëmarrje në Ankand bëhet duke dorëzuar aplikacionin me ofertë në kuvertë të mbyllur.

Oferta duhet të përmbajë: shënimet e ofertuesit, numrin e këtij njoftimi, datën e përpilimit të ofertës, titullin OFERTË, shënimin mbi sportelin për të cilin konkurohet në ankand, çmimin ofertues të shënuar me numër dhe shkronja, emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e ofertuesit për personin fizik, ndërsa për personin juridik edhe funksionin e personit përgjegjës.

Oferta e personit fizik duhet të nënshkruhet nga personi fizik, ndërsa oferta e personit juridik nënshkruhet dhe vulolet nga personi përgjegjës i personit juridik.

Oferta për pronën e caktuar duhet të vendoset në kuvertë të mbyllur.

Kuverta në faqen e pare duhet të përmbajë shënimin:

**Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të
Komunës së Pejës
Pjesëmarrje në Ankand Publik**

Tërheqja e aplikacionit (formularit) mund të bëhet në ndërtesën e Komunës, Qendrës për Shërbim me Qytetarë ose në Web faqen e Komunës së Pejës.

Aplikacioni (formulari) bashkë me ofertën në kuvertë të mbyllur dorëzohet brenda **afatit prej 15 ditësh** nga dita e shpalljes së këtij Njoftimi deri në ora **14:30 në ndërtesën e Komunës Qendrrën për Shërbim me Qytetarë..**

Ofertat e paprecizuara, të panënshkruara dhe të ofertuara me çmim më të ulët se çmimi fillestar i publikuar me këtë Njoftim si dhe ofertat që nuk i përshtaten apo nuk i përputhen kushtit kryesor të këtij ankandi (ofrimi i aktiviteteve shërbyese financiare), nuk do të shqyrtohen.

nuk do të shqyrtohen.

Gjatë hapjes së ofertave në ankand publik marrin pjesë nënshkruesit e ofertave përkatësisht të autorizuarit e tyre me autorizim noterial.

Komisioni në ankand i bën publike çmimet e ofertuara të secilës ofertë për sportelin përkatës.

Konform nenit 12 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për caktimin e procedurave të dhënjës në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës përmes ankandit publik Komisioni bën përzgjedhjen e fituesit në bazë të çmimit më lartë të ofruar në ankand publik.

Njoftimi për ofertën e përzgjedhur do ti dërgohet fituesit, do të publikohet në Webfaqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Informatat shtesë mund të merren në Ndërtesën e Komunës, Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike ose në tel. **039 200 43477**

Datë: 31.08.2026

Nr. 15-463101-66086

KOMISIONI:

1. Gentiana Bajrami- Atashi _____
2. Fatime Shala _____
3. Diellëza Berisha _____
4. Arta Vokshi- Nallbani _____
5. Agim Nikqi _____

